

Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme

Tipi i programit: Themelor

Hyrje:

Kursi “Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme” është zhvilluar nga KEC, në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (apo BEP, i financuar nga USAID) për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit 21 tek nxënësit e shkollave fillore.

Në vitin 2012, Programi BEP ka bërë një vlerësim të të lexuarit në klasat e hershme, në 40 shkolla të Kosovës, duke shfrytëzuar një instrument të hartuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila shfrytëzohet në vendet partnere të USAID-it. Ky instrument quhet EGRA – Early Grade Reading Assessment (Vlerësimi i të Lexuarit në Klasat e Hershme). EGRA për gjuhën shqipe është adaptuar nga BEP-i dhe ka marrë emrin A-EGRA (Albanian EGRA). Nga hulumtimi i zhvilluar, ka dalë se fëmijët e klasave të hershme më së dobëti qëndrojnë me të kuptuarit e të lexuarit (lexim-kuptimin) dhe me rrjedhshmërinë në të shprehur. Si rrjedhojë, është hartuar kursi nga një grup punues i përbërë nga konsulentë ndërkombëtarë e vendorë dhe janë certifikuar 4602 mësimitdhënës klasorë dhe 413 fasilitatorë shkollorë në nivel vendi.

Përshkrimi i kursit

Kursi “Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme” është konceptuar për t’u ofruar me bazë në shkollë, për të gjithë mësimitdhënësit e shkollës fillore. Programi realizohet në formë të kursit treditësh. Së pari mbahen dy ditët e para. Pas kësaj, mësimitdhënësit kanë dy javë kohë që të realizojnë aktivitetet praktike në shkollë. Në fund, mësimitdhënësit mbajnë ditën e tretë të kursit, të cilën e fillojnë me një seancë reflektimi mbi përvojat nga aktivitetet në klasë. Njëkohësisht ata prezantojnë dosjet e zhvillimit profesional të tyre, dhe fasilitatorët e kolegët japin informata kthyesë. Kjo dosje kontrollohet nga fasilitatorët dhe drejtori i shkollës, nga të cilët dalin rekomandimet për përmbushjen e kriterëve për certifikim. Pas përfundimit të kursit, pjesëmarrësit vazhdojnë t’i zbatojnë teknikat e kursit në mësimitdhënien e tyre dhe vazhdojnë ta mirëmbajnë/plotësojnë tutje dosjen e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve.

Te ky kurs, sikur edhe në kurse tjera, Programi po ndërton kapacitetet e fasilitatorëve shkollorë, në secilën shkollë pjesëmarrëse, prandaj prania e këtyre fasilitatorëve siguron mbështetje të

vazhdueshme për mësimdhënësit e atyre shkollave. Me këtë, sigurohet qëndrueshmëri e veprimit dhe krijimi i komunitetit të të nxënësve në shkollë.

Qëllimi i kursit:

T'u ofrohet mësimdhënësve të shkollës fillore një program pune që fokusohet në zbatimin e teknikave dhe strategjive për të përmirësuar shkathtësitë e shkrim-leximit të nxënësve të klasave të hershme.

Rezultatet e të nxënësve

Pas përfundimit të kursit, vijuesit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë fazat e zhvillimit të shkathtësive të shkrim-leximit të fëmijëve të moshave të reja;
- Të dallojnë komponentët e shkrim-leximit dhe t'i lidhin ato në procesin e zhvillimit të shkathtësive gjuhësore të nxënësve;
- Të përvetësojnë strategji dhe teknika për ngritjen e shkathtësive të nxënësve për vetëdijen fonemike, fonetikën, dëgjim-kuptimin, lexim-kuptimin, rrjedhshmërinë dhe fjalorin;
- Të identifikojnë llojet e vështirësive që nxënësit hasin në lexim dhe të përvetësojnë strategji për t'u ndihmuar atyre nxënësve;
- Të praktikojnë teknika të krijimit të librave, për të ushqyer shkathtësitë e të shkruarit të nxënësve;
- Të demonstrojnë shkathtësi për të analizuar aspektet gjinore dhe koherencën shoqërore në tekstet shkollore dhe librat tjerë për fëmijë;
- Të analizojnë mënyra të ndryshme për angazhimin e prindërve në zhvillimin e shkathtësive të shkrim-leximit të fëmijëve të tyre.

Zbatimi i kursit (metoda, forma, dhe vendi):

Kursi "Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme" do të zbatohet si vijon:

1. Kursi treditësh (24 orë)

Punëtoritë fasiltohen nga 2 fasilitatorë të aftësuar dhe certifikuar nga KEC. Secila nga tri ditët e kursit ka nga katër sesione pune 90 minutëshe.

2. Aktivitetet në shkollë – zbatimi i teknikave në klasë dhe zhvillimi i dosjes profesionale

Mësimdhënësit hartojnë njësi mësimore të bazuara në metodologjinë e kursit dhe i zbatojnë ato në klasat e tyre. Ata njëkohësisht, zhvillojnë dosjen e tyre profesionale e cila përmban njësitë e

planifikuara mësimore, fotografi/video, punime të nxënësve, reflektime personale, informata kthyesë nga kolegët/et, etj.

3. Mbështetja e mësimdhënësve nga fasilitatorët/kolegët

Për të mbështetur mësimdhënësit gjatë punës së tyre shkollë, KEC inkurajon mësimdhënësit që të shfrytëzojnë ekspertizën e fasilitatorëve shkollorë për të kërkuar ndihmë në formë këshillimi apo forma tjera që të realizojnë qëllimet e zhvillimit të shkathtësive të shkrim-leximit të nxënësit. Poashtu, inkurajohen takimet e shkurtra/seancat e shkëmbimit të përvojave mes kolegëve.

Vlera e aktiviteteve të kursit e shprehur në orë për licencim

Programi ka gjithsej 24 orë.

Certifikimi

Kushtet për certifikimin janë:

1. Pjesëmarrja me rregull në kurs, së paku 90% të kohëzgjatjes së kursit
2. Zbatimi i së paku pesë (5) njësive mësimore sipas metodologjisë së kursit, i dokumentuar përmes dosjes së zhvillimit profesional.
3. Shikimi i dosjes së zhvillimit profesional nga drejtori dhe rekomandimi i tij/ saj për përmbushjen e kriterëve për certifikim.